



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.33/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Subjekteve Politike (ZRPPC) - KQZ, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Turk Birligi (KTB) me seli në Mamush, për shkak të mosdorëzimit të Raportit Financiar të Shpenzimit të Fushatës Zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 12.03.2014, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Subjekteve Politike (ZRPPC) KQZ, kështu që subjekti politik Kosova Turk Birligi-KTB, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3000 (tremijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë nga ZRPPC të KQZ-së në të cilën theksohet se subjekti politik Kosova Turk Birligi-KTB nuk e ka dorëzuar Raportin e Deklarimit Financiar në këtë institucion, i cili kërkohet në bazë të Nenit 40.5 dhe 119.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe në bazë të nenit 7.6 të Rregullës Zgjedhore nr.12/2013

Parashtruesi i ankesës vërteton se subjekti politik Kosova Turk Birligi-KTB nuk e ka sjell Raportin Financiar, që ka qenë deri më 18 Dhjetor 2013 për Raundin e parë (I).

PZAP-i, e informoi subjektin politik Kosova Turk Birligi-KTB, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 05.03.2014, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 07.03.2014, në ora 10:00.

PZAP nuk mori përgjigjen e kërkuar.

PZAP-i, pas administrimit të pretendimeve ankimore, PZAP-i gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Neni 40.1 (Kërkesat për Deklarim Financiar) të LZP-së, përcakton se: *çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.*

Në këtë kontekst, subjekti politik Kosova Turk Birligi-KTB ka qenë i detyruar në bazë të këtij ligji që të dërgoj Raportin Financiar për Raundin e Parë (I), jo më vonë se 18 Dhjetor 2013 – gjë që nuk ka ndodhur, prandaj mbi këtë bazë pretendimet ankimore janë të bazuara.

Gjatë përcaktimit të shumës së përshtatshme për gjobitjen e ndonjë subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë
- Masat, nëse ka pasur fare të tilla, të cilat janë ndërmarrë apo miratuar nga subjekti politik për të parandaluar shkelje të ligjeve përkatëse zgjedhore në Kosovë;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në ndonjë palë zgjedhje në të kaluarën.

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se subjekti politik në fjalë ka rënë në kundërshtim më nenin 40 paragrafi 1 të LZP-së, për shkak se nuk e ka dorëzuar raportin e financiar gjatë periudhës së fushatës zgjedhore siç kërkohet më dispozitën e lartcekur. PZAP-i ka marr si rrethanë rënduese faktin se subjekti politik në fjalë ka marr pjesë edhe më parë në zgjedhjet të organizuara në Kosovë dhe me këtë rast subjekti politik në fjalë nuk e ka dorëzuar raportin e publikimit financiar sipas afatit të paraparë ligjor, veprime këto që janë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Për lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i vendosi duke u bazuar në nenin 120 paragrafi 1, pika c të LZP-së, në të cilin specifikohet se: “Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e Rregullave Zgjedhore të KQZ-së mund të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri në pesëdhjetëmijë euro (€50,000)”.

Andaj, bazuar nga arsyet e theksuar më lart dhe bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP, në të cilin parashihet se: *PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet*, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 33/2014 më datën 12.03.2014.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*